



Shoqëria e Arteve të Bukura

Prezanton

FESTIVALIN N. 12

Në Theatron e Kopsht. Mitropolisë

Të Dielë, 6 Prill 1924 për familjet

Të Martë, 8 Prill 1924 për të gjithë

Me Ndihmën e

Bandës Kombëtare "Vatra" 'nënë përbajtjen e Bashkisë Korçës, Korit
Orkestrës, Mandolinatës dhe Trios së Shoqërisë, Nadame Leglise.

Z. Pierre Leglise, Zonjës Nassi dhe Z. Ch. Roland.

Direktor Muzikal THOMA NASSI

Programi

- GOLDMARK op. 13. *Sakundala, Overture.* Do tē lohet prej Bandës [Kombëtare.]
- J. IVANOVICI *Blanches Colombs Vals.*
- G. BIZET. *Intermezzo nga "L' Arlesienne"*
- S. LOPE *Ali Baba.* Do tē lohen prej Orkestrës.
- NASSI—HIL MOSI *Larg Saj.* Do tē këndohet prej Korit tē Shoqërisë.
- Pablo de Sarasate op. 22. *Romanza Andalusia.* Sollo nē violi. Do tē lohet [prej Zotit Ch. Roland. Zonja Nassi do t'a akompanonjë.]
- VERDI *Celeste Aida.* Do tē këndohet prej z. Pièrre Leglise. Zonja Leglise [do t'a akompanonjë.]
- ROSSINI *Barbier de Seville.* Kënga e Rosinës do tē këndohet prej Ma- [damme Leglise,

10 Minuta Pushim

- C. PFLUEGEL--ODELL *Vesper Time. Meditation.*
- J. OFFENBACH--ODELL "Belle Nuit" *Barcarole.* Nga përrallat e Hoffmanit.
- H. F. ODEL *Beautiful Rainbow Waetz.* Do tē lohen prej Mandolinatës.
- F. CHOPIN *Prelude, Op. 22, N. 15. Solo Piano.* Do tē lohet prej Zonjës Nassi
- TH. BOEHM. *Op. 22. Variasione përmi një këngë gjermane Du, du liegst [mir im Hersen. Solo flaute.* Do tē lohet prej Zotit Nasi. Zonja Nassi do tē akompanjonjë.]
- SCHUBERT a) *Barcarole.* b) *Serenade.*
- BOCCHERINI *Minuit.* Do tē lohet prej Zonjës Nassi, Z. Roland dhe [Z. Nassi.]
- AUBER *Diamandet e Kurorës. Grand Fantasia.* Do tē lohet prej Bandës [Kombëtare "Vatra".

Ky program mban dy orë e gjysmë.

Zonjat dhe Zotërinjtë janë të lutur të mosfjalosen në kohën kur lohen pjesati Komisioni u falet nderit gjithë atyre që muar pjesë në këtë program, dhe veçanërisht të luajve të nderuar Madame Leglise, Prof. Leglise, Prof. Roland.

Komisioni cfaq botërisht falenderjet famitjes Adam (Bardhush) që pati mirësinë t'i luajë pianon për këtë koncertë.

Overtura Sakundala u dha tē parēn herē nē Vienē mē 1865 dhe shenoj suksesin e parē tē Goldmarkut si kompozonjës. Overtura pikturon përallën me këtë emër tē shkrojtur prej Kalidasa-se, vjershëtoe dhe dramatist Indian.

Sakundalaja një bijë e një nuse-iji, adoptohej si bijë prej një prifti dhe sillet prej atij nē një pyll tē shënjtë. Mbreti Dushante duke gjuajtur një ditë hyn nē këtë pyll dhe shikon Sakundalane, bije nē dushuri dhe martohet me 'të. Me që nuk munt t'a marrë pas atë çast i jep nje unazë pér tē identifikuarë atë kur tē vinte t'a bashkonte mbretin nē qytet. Këtë kohë një tjetër prift duke u shtyrë nga shkake çgjakësimi i bën magji mbretit dhe ay haron farë Sakundalane. Kjo kur lahet nē një lumë humbet unazën nē lumë. Kur pas pak kohë prezantohet pérpara mbretit ay nuk e njeh dhe e dbon. Mëma e Sakundalase i vjen ndihmës, dhe unaza e saj gjendet prej një peshkatari dhe sillet pérpara mbretit. Mbreti kur shikon unakën kujton Sakundalane, mallëngjehet dhe niset pér tē e gjetur. Në një luftë kundër demonëvet gjen dhe fiton Sakundalane dhe bashkohen tē lumtur.

Overtura (e cila është shkrojtur pér orkestër po e përkthyer pér bandë), hapet me një melodi nē Bariton dhe nē Bür Saxofoni. Pas pak masash, Klarinetat dhe Baritoni këndojnë themën e parë, e cila është një melodi dashurie me përcjellje tē butë. Passi punohet kjo themë dëgjohet një tjatër themë, një melodi gjatore, e lojtur prej brinjëve: dhe kornetavet. Pas një developimi hyn nē një fortissimo prej gjithë strumentavet. Pas kësaj, dëgjohet një melodi shum' e ëmbel ne oboe dhe nē një bërtitje harmonike prej tē gjithë strumentavet. Allegro-ja nis pianissimo dhe mbaron fortissimo dhe mbyll pjesën e parë tē Overturës me një klimax tē gjallë. Pas fantasisë së lirë pason Coda e bazuarë përmi themën e melodisë së gjahut dhe na udhëheq me një fortissimo nē prezantimin e themës së parë dhe së dytë. Një klimax duke nisur përsëri me themën e gjahut mbyll overturen.

Valsi Pëllumbat e Bardhë i Ivanoviçit është një nga më të bukurit që ka shkrojtur ky kompozonjës modern.

Intermezzo-ja marrë nga "L' Arlesienne" një nga të 2 suitat e famëshme tē Bizetit është plot fuqi dramatike dhe ngjyra tonale. **Ali Babaj** një pjesë e vogël me muzikë, orientale shigurisht do t'u pëlqejë tē gjithëve.

Romanza Andalusia që do tē lohet prej Z. Roland është pjesa e III e "Valleve Spagnole" tē Sarasatës. Një pjesë që lup një mjeshtëri tē madhe nē violinë, po tē cilën e intarpreton me mjeshtëri tē madhe Zoti Roland.

Kënga nga **Berberi i Seviles** që do tē këndonjë Zonja Leglise është një nga më të bukurat dhe më tē zorshmet këngë tē asaj opere tē famëshme. Korçarët nofta pér tē parën herë do tē kenë rastin tē shijojnë një Soprano tē mirë brënda nē Korçë. **Celeste Aida** që këndon me aqë mjeshtëri Zoti Leglise është mjaft e njohur sa nuk do komente.

Mandolinata këtë herë e riorganizuar na jep tri buketa tē bukura që do tē shijohen prej tē gjithëvet. "Barcarolla e Offenbachut" është mjaft e njohur sa ç' do shpjegime.

Trioja me një tjatër buketë tē interesaqësme dy tē botëfamëshmit Schubert dhe një tē Boccherinit. Pak fjalë përmi **Serenadën** tē pavdekur tē Schubertit. U shkrojt më 1826. Është aq' familiare nē tē gjithë sa uuk do analizim. Është një melody e dashur dhe e ëmbël që prej notes së parë gjer me atë tē fundit, e shkrojtur me inspiratën e një minutë po tē cilën nukë lodhet njeriu kurre që t'a dëgjojë. Von Hellbomi, shkrimitari i jetës së Schubertit, thotë këto pér këtë serenadë:

"Një tē Dielë tē verës tē vitit 1826 Schuberti me shumë miq tē tjerë kur këtë ehej pëqë Pretzleinsdorfi nē qytet pa mikun e tij Tieze që rinte më një tryezë në kopshtin e "Zum Biersack". Të gjithë shokët përfundnan tē tē qendrojnë pér pak këtu. Tieze kish një librë tē hapur pérpara tij dhe

Schuberti nisi tē kthenjë fletet, kur me një herë qëndroj duke u treguarë shokëve një vjershë dhe duke thënë: «M'ardhi nér mënt një copë melody e hembël pér këtë vjershë por fatekeqësisht nuk kam nonjë copë kartë muzike që t'a shkruanç dhe do t'a haronj. Ahere Herr Doppleri me shpëjtim rëmbëu nga tryesa një listë gjellësh që u ndoth atje, hoqi vija nga ana e grapë dhe i a dorëzoj Schubertit, dhe ay, tē tengëllimit tē piatavet këngëvet tē grupeve tē ndryshme, shamatës së fëmijëvet dhe lojtjes së violivet dhe tē urdhëravet tē servitorëvet shkrojti atë melody aqë tē bukur».

Për Diamandet e Kurorës, pjesën e funtme tē programit, kemi bëre fjalë tjejér herë.

Personeli i Bandës.

Flauta, piec	Klarineta	Vani Boboshtica
Z. Morçka	R. Sarro	Trombone
Saxofon	L. Lubonja	P. Peci
P. Bexho	G. Trebicka	Basso
Korneta	Kr. Kono	I. Shagla
M. Melka	Brinjë	Drome
Ali Take	K. Vasil, Ar. Vasil	Kr. Vasil
Th. Papahristo	Baritone	V. Kristo
Xh. Mehmet	K. Panduku	

Personeli i Orkestrës

Violinë	Contrabass	Trombone
P. Leglise	Olimbi Nassi	P. Peci
An. Ballauri	Flaute	Bariton
Kr. Avram	Z. Morçka	K. Panduku
Vas. Ballauri	Klarinete	Korneta
Nik. Karafili	R. Sarro	M. Melka
Violoncello	Piano	Drome
Ch. Roland	Mad. Leglise	Kr. Vasil

Personeli i Mandolinatës

Mandolina	Mandolla	Sifku Ballauri
Taqi Fundo	Kr. Ballauri	Kostaq Kotta
Kristo Niço	Mandocello	Dhim. Kondili
An. Ballauri	Andon Frashëri	Flanta
Nodhi Lako	Violoncello	Z. Morçka
Vas. Ballauri	Ch. Roland	S. Mio
Nik. Karafili	Qithara	Piano
Ref. Kasimiati	Sotir Tiko	Olimbi Nassi
P. Bogadini		

Personeli i Korit

S. Ballauri	K. Niço	Z. Morçka
Dh. Kondili	P. Bogadini	K. Kono
Kr. Mitace	A. Frashëri	A. Vasil
P. Peri	S. Tiko	K. Panduku
T. Fundo	Kr. Avram	P. Bexho
V. Ballauri	A. Ballauri	

Pleqësia e Shoqërisë tē Arteve Bukura

L. Naçi, K. Mitace, T. Fundo, K. Vasil, L. Lubonja, K. Niço, V. Mio, J. Adham, M. Sherko, A. Frashëri, Th. Nassi.